




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.554/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z.Goran Mileković - Kryetar, z.Nuhi Paçarizi - Referues, z.Blerim Dina - anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik:OE“ NT Agimi-DE ”- Deçan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “Erpo Print ”- Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull :“ Furnizim me material të shtypur për nevojat e Komunës së Gjakovës ”, me numër të prok: 632-19-1137-111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/, Komuna e Gjakovës, më datë: 24.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “ NT Agimi-DE ”- Deçan ,lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:“ Furnizim me material të shtypur për nevojat e Komunës së Gjakovës ”, me numër të prok:632-19-1137-111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/, Komuna e Gjakovës.

II. VËRTETOHET, vendimi i AK-së -njoftimi për dhënien të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:“ Furnizim me material të shtypur për nevojat e Komunës së Gjakovës ”, me numër të prok:632-19-1137-111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/, Komuna e Gjakovës.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “ NT Agimi-DE ”- Deçan, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Afati për dorëzimin e ofertës ka qenë deri më: 26.04.2019.

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt: 18.03.2019.

Kërkesa për rishqyrtim është bërë me dt: 23.08.2019

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar është bere me dt:21.08.2019

Vendimi i AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim bërë me dt: 26.08.2019

Operatori ekonomik ankues:“ NT Agimi-DE ”- Deçan , si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me dt.30.08.2019, me nr.554/19,kundër njoftimit për dhënie të kontratëslidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:“ Furnizim me material të shtypur për nevojat e Komunës së Gjakovës ”, me numër të prok:632-19-1137-111,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/AK/,KK Gjakova , duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 59 ,60, 61 dhe nenin 69të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit,konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë:03.09.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit,në raportin e dt: 12.09.2019, sqaron sinë vijim : Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, pas pranimit te vendimit nr: 356/19, e ka kthyer ne rivlerësim këtë aktivitet te prokurimit. Sipas raportit te vlerësimit, komisioni rivlerësues ka kërkuar sqarime nga drejtoria për Buxhet dhe Financa, lidhur me pagesat e bëra për OE te rekomanduar për kontrate dhe sipas kartelës financiare rezulton se pagesat për operatorin ekonomik te lartpërmendur janë bere ne vlere prej: 60,245.76€ deri me datën:

07.03.2019. Pra, duke u bazuar ne te dhënat e raportit te rivlerësimit, sqaroj se komisioni rivlerësues ka marr për baze kartelën financiare si dokument për verifikimin e kohës se mbarimit te këtij projekti.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se, AK-ja ka bere ri-vlerësimin e ofertave për faktin se ne kërkesë AK-ja ka kërkuar qe: listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve, dhe ne rastin konkret nuk mundet qe AK-ja te përdore dëshmi tjetër sepse kartela financiare dhe pranimi teknik nuk janë dokumente ekuivalente dhe njeherit është ne kundërshtim me paragrafin 4 te nenit 59 te LPP-se.

Eksperti shqyrtues, poashtu vlerëson se nuk është respektuar vendimi i PSH-se nr: 356/19, ne te cilin decidivisht sqarohet çështja e kontratave dhe referencave te OE te rekomanduar për kontrate.

Lidhur me këtë çështje edhe eksperti shqyrtues ka dhënë një vlerësim ne raportin e pare te ekspertizës prandaj konform rregullores se punës se OSHP-se, e njoftoj panelin shqyrtues se pretendimet ankimore te OE ankues janë te njëjta me ato te herës se pare, andaj duhet te trajtohet si çështje e gjykuar me pare – “ResJudicata”.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet vendimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 17.09.2019 , me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë:13.09.2019, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, sepajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 24.09.2019, ku kanë qenë prezentë gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesi i OE-së ankues, përfaqësuesit e AK-së, ndërsa Eksperti Shqyrtues ka njoftuar se nuk mundet te marre pjese ne seance dhe njeherit mbetet prapa mendimit te dhënë ne ekspertize,u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Buzuku deklaroj: Ne si kompani qëndrojmë prapa pretendimeve ankimore dhe pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Halil osmani deklaroj: Komisioni i vlerësimit ka shqyrtuar ofertën e OE më të lire dhe OE ankues pretendon se nuk është kryer në tërësi koha e kontratës dhe vlera e kontratës dhe komisioni i vlerësimit e ka marr nga thesari nga fillimi i kontratës deri me skadimin e saj dhe kanë propozuar për të shpërblyer OE me të lire. Dëshmitë tjera i kemi dorëzuar me lende po e dorëzoj edhe dëshminë e raportit të zyrës së thesarit.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Buzuku deklaroj : Kërkojmë të aprovohet ankesa jone si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Halil osmani deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues të hedhe poshtë ankesën e OE ankuese dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK-ja, pas pranimi të vendimit nr: 356/19, aktivitetin e prokurimit në fjalë e ka kthyer në rivlerësim. Sipas raportit të vlerësimit, komisioni rivlerësues ka kërkuar sqarime nga drejtoria për Buxhet dhe Financa, lidhur me pagesat e bëra për OE të rekomanduar për kontrate dhe sipas kartelës financiare rezulton se pagesat për operatorin ekonomik të lartpërmendur janë bere në vlere prej: 60,245.76€ deri me datën: 07.03.2019. Pra, duke u bazuar në të dhënat e raportit të rivlerësimit, sqaroj se komisioni rivlerësues ka marr për baze kartelën financiare si dokument për verifikimin e kohës së mbarimit të këtij projekti, e që në baze të këtyre dëshmimeve OE në fjalë plotëson kërkesën e autoriteti kontraktues të specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarimet e nevojshme nga OE i rekomanduar për kontratë, ashtu siç është kërkuar me vendimin PSH 356/19, dhe nga provat e prezantuar vërtetohet se OE në fjalë plotëson kërkesën e autoriteti kontraktues.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, si dhe vendimi . Autoriteti kontraktues gjatë rivlerësimit të ofertave i është përmbajtur në përgjithësi të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues


Z. Goran MILENKOVIĆ

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK -Komuna e Gjakovës

1x1 OE -" NT Agimi-DE "- Deçan

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim nëweb- faqe të OSHP-së.